

## 1. Informacion i përgjithshëm

ILIRIA 98 Sh.p.k ("Shoqëria") e filloi aktivitetin e saj në 1998 ME OBJEKT KEMBIME VALUTORE.. Shoqëria është regjistruar si një person juridik sipas vendimit të Gjykatës datë 19019, DATE 12/03/1998, me numër NIPT-i K11329003H. Zyra qendrore është vendosur tek Teatri I Kukullave, Tirane, Shqipëri.

Tre aksionerët e Shoqërisë janë: Edmond Ymeri me 33.33 %, z. Ilir Janku me 33.33 % dhe z. Ali Topalli me 33.33 % të kuotave të Shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është kembimi valutator.

Në 31 dhjetor 2020, Shoqëria kishte 43 punonjës, numri mesatar i punonjesve për vitin 2020 është 41 (2019: 40 punonjës).

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### Deklarata e përputhshmërisë

Politikat kryesore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar ("SNRF").

### Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

### Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha e raportimit është Leku Shqiptar ("Lek") që është gjithashtu edhe monedha funksionale.

#### (a) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

**Shoqëria nuk ka gjykuar për çmuarje kontabël që pasqyrohen në PF të shoqërisë.**

## 3. Konsekuenca e politikave kontabile

Politikat kontabël më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

### (e) Aktive afatgjata materiale

#### Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi (shih politikën kontabël (e)(ii)).

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrë të synuar.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (elementët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja që vjen nga pakësimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet duke krahasuar shumën e arkëtuar nga pakësimi me vlerën kontabël të zërit, dhe njihet në baza neto në të ardhurat/shpenzimet e tjera operative në fitim ose humbje.

#### Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij



(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

**Amortizimi**

Amortizimi njihet në fitim ose humbje si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Jeta e dobishme/ norma e amortizimit
Ndërtesa dhe instalime	Mbi vlerën e mbetur	5%
Pajisje	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mjete transporti	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mjete transporti me qera financiare	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vlerën e mbetur	20-25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohet në cdo datë raportimi.

**(f) Aktivet me qera**

Qeratë, në kushtet e të cilave Shoqëria merr në thelb të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë, janë të klasifikuara si qera financiare. Në momentin e njohjes fillestare, aktivi me qera, matet me një shumë të barabartë me vlerën më të vogël midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qerasë. Pas njohjes fillestare, aktivi kontabilizohet në përputhje me politikën kontabël të zbatueshme për atë aktiv.

Qeratë e tjera janë qera operative dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë.

**(g) Inventarët**

Inventarët janë vlerësuar me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet bazuar në parimin e koston mesatare të ponderuar dhe përfshin koston e blerjes, kostot e shndërrimit dhe gjithë kostot e tjera për të sjellë inventarët në vendodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus kostot e vlerësuar të përfundimit e shitjes.

**(h) Instrumentat financiarë**

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë të përberë nga mjete monetare dhe ekuivalente me to, klientë dhe të tjera llogari të arkëtueshme, furnitorë dhe të tjera llogari të pagueshme dhe huamarrje.

Shoqëria fillimisht njehtë arkëtueshmet dhe depozitat në datën e krijimit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse ajo i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Aktivitet dhe detyrimet financiare prezantohen neto në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm në rast se Shoqëria ka të drejtën ligjore dhe qëllimin për të shlyer ose arkëtuar njëherësh detyrimin ose të drejtën neto.

**Klientë e të tjera të arkëtueshme**

Të arkëtueshmet janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit. Në vazhdim, të arkëtueshmet maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet kumulative nga zhvlerësimi (shih shënimin 3(e)(i)).

Shoqëria nuk ka gjendje klientesh, veprimet janë ditore dhe kryesisht në cash.

**Mjete monetare dhe ekuivalente me to**

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë paratë në arkë, depozitat rrjedhëse në banka dhe investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet original tre muaj ose më pak, për të cilat risku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, dhe Shoqëria i përdor për manaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.



*Detyrime financiare*

Detyrime të tjera financiare përfshijnë huamarrjet, llogari dhe të tjera të pagueshme.

Shoqëria fillimisht nje llogaritë e pagueshme në datën kur ato janë krijuar. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar. Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë plus koston direkte të transaksionit. Në vazhdim, këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në politikën kontabël 3 (j).

*Kapitali aksioner*

Kapitali aksioner i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

**(i) Zhvlerësimi**

**(i) Aktive financiare**

Një aktiv financiar, i cili nuk regjistrohet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive që tregon se mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse evidenca objektive e zhvlerësimit tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit financiar dhe kjo mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare të zhvlerësohen mund të përfshijë mospagimin nga huamarrësi, ristrukturimin e e shumës që i detyrohet Shoqërisë me kusht që Shoqëria nuk do t'i kishte konsideruar në një rast tjetër, të dhëna që një huamarrës do të falimentojë, ndryshime negative në statusin e pagesave të huamarrësit ndaj Shoqërisë, kushte ekonomike që lidhen me dështimin e pagesave ndaj Shoqërisë ose zhdukja e një tregu aktiv për letrat me vlerë.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar.

Aktivitetet financiare të cilat janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vlerësohet bashkarisht në grupe që mbartin karakteristika të ngjashme risku. Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor trendet historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anullimi njihet në fitim ose humbje.

**(ii) Aktive jo-financiare**

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, është rishikuar në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e aktivitetit ose e njësisë gjeneruese të aktiveve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Një njësi gjeneruese e parasë është grupi më i vogël i identifikueshëm që gjeneron flukse monetare gjerësisht të pavarura nga grupet apo aktivet e tjera. Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo e një njësie gjeneruese të parasë është me e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë të tij pasi janë zbritur shpenzimet e shitjes.

Përsa i përket aktiveve të tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka tregues që kjo humbje nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në atë masë sa vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar si vlerë neto pas zbritjes së amortizimit dhe nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

*Ve la-financiare*





**(j) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga shitja gjatë rrjedhës së aktivitetit normal të biznesit maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë, përjashtuar skontot tregtare dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet domethënëse të pronësisë i janë transferuar blerësit, është e mundur marrja e shumës së konsideruar, kostot shoqëruese dhe kthimet e mundshme të të mirave janë të vlerësueshme në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të manaxhimit me mallrat, dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.

E ardhura nga shërbimet e kryera njihet në fitim ose humbje në proporcion me fazën e realizimit të transaksionit në datën e raportimit.

**(k) Pagesat e qerasë**

Pagesat e bëra për qeranë operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qerasë. Stimujt e marrë për qeranë njihen si pjesë integrale e pagesës totale të qerasë përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

Pagesat minimale të qerasë të bëra nën kontratat e qerasë financiare ndahen në mes të shpenzimeve financiare dhe pakësimit të detyrimit të mbetur. Shpenzimi financiar shpërdahet për cdo periudhë gjatë afatit të qerasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike interesi mbi tepricën e mbetur të detyrimit.

Pagesat e pritshme të qerasë regjistrohen duke riparë pagesat minimale të qerasë gjatë periudhës së mbetur të saj kur korigjimi i qerasë konfirmohet.

**(l) Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, risqet specifike të detyrimit. Amortizimi i skontos njihet si kosto financiare. Provizioni për garancitë njihet kur produkti ose shërbimi janë shitur. Provizioni bazohet në të dhënat historike për garancitë dhe ponderimit i të gjithë flukseve dalëse të mundshme me probabilitetet përkatëse.

**(m) Përfitimet e punonjësve**

*Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

*Pagesa për lejet vjetore*

Shoqëria njihet si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

**(n) Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet në banka. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huamarrjet.

Kostot e huasë që nuk lidhen direkt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi që kualifikohet për kapitalizimin e këtyre kostove, njihen direkt në rezultat duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi nëse lëvizjet në kursin e këmbimit janë në një ekspozim neto fitimi apo humbje.



**(o) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje.

**(p) Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin apo humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Aktivt dhe pasivet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet për tatimin aktual të pagueshëm ndaj tatimit të parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe tatimet dhe interesat shtesë që mund të lindin. Shoqëria beson se përlogaritja e detyrimeve tatimore është e saktë për të gjitha periudhat e tatueshme bazuar në vlerësimin e disa faktorëve, duke përfshirë interpretimin e legjislacionit tatimor dhe ekperiencën e mëparshme. Kjo përlogaritje mbështetet në vlerësime dhe supozime si dhe mund të përshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme.

Në rast se si rrjedhë e disponimit të një informacioni, gjykimi i Shoqërisë për mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese ndryshon, ky ndryshim do të reflektohet në shpenzimin tatimor të periudhës kur ai përcaktohet.

**Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit financiar të mëparshëm, përveç SNRF-ve të ndryshuara në vijim të cilat janë adoptuar nga Kompania më 1 janar 2019:

- SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët
- SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja
- KIRFN 22 Interpretim - Transaksionet dhe Paradhënia në Monedhë të Huaj
- Transferimet e Aktiveve afatgjata materiale të investuara - Ndryshimet në SNK 40
- SNRF 2 - Klasifikimi dhe matja e Transaksioneve të "Pagesave të bazuara në aksione" – Ndryshime në SNRF 2
- Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet financiare me SNRF 4 Kontratat e sigurimit - Ndryshimet në SNRF 4
- SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta - Sqarim se matja e e te investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje specifike për cdo investim.





- **SNRF 1 - Adoptimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar për herë të parë - heqja e përjashtimeve afatshkurtrapër adoptuesit e parë**

Ndonëse këto standarde dhe amendamente të reja aplikoheshin për herë të parë në vitin 2018, ato nuk patën një ndikim material në pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë. Natyra dhe ndikimi i çdo standardi të ri ose amendimi përshkruhet më poshtë:

- **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët**

SNRF 15 përcakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve financiare që nuk janë një prodhim i veprimtarive të zakonshme të njësisë (p.sh., shitja e pronës, e pajisjeve apo aktiveve të paprekshme). Dhënia e gjerë e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshirë ndarjen e të ardhurave totale; informacionin mbi detyrimet e performancës, ndryshimet në balancat e logaritjeve të aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, si dhe gjykimet dhe vleresimet kryesore.

Aplikimi i këtij standardi nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- **SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja**

Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Faza përfundimtare e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesat e reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin mbrojtës.

Zbatimi i këtij standardi nuk ka efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë. Miratimi i SNRF 9 ka ndryshuar rrënjësisht kontabilitetin e Kompanisë për humbjet nga zhvlerësimi për aktivet financiare duke zëvendësuar metodën e humbjeve të ndodhura me SNK 39 me një qasje të pritshme të humbjes së kredisë (ECL).

- **KIRFN 22 Interpretim - Transaksionet dhe Paradhënia në Monedhë të Huaj**

Interpretimi sqaron se, në përcaktimin e kursit të këmbimit të castit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivitetit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tij) në c' regjistrimin e një aktivi jo-monetar ose detyrimi jo-monetar që lidhet me paradhënien, data e transaksionit është data në të cilën njësia ekonomike fillimisht njeh aktivin jo-monetar ose detyrimin jo-monetar që rrjedh nga parapagimi. Nëse ka disa pagesa ose arketime në avancë, atëherë njësia ekonomike duhet të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë ose arkëtim në avancë lidhur me paradhënien.

**Standardet dhe interpretimet efektive në periudhënaktuale (vazhdim)**

Subjektet mund të aplikojnë ndryshimet në bazë të plotë retrospektive. Në mënyrë alternative, një njësi ekonomike mund të zbatojë Interpretimin në mënyrë prospektive në të gjitha aktivet, shpenzimet dhe të ardhurat në fushën e saj që njihen fillimisht në ose pas:

- i. Fillimi i periudhës raportuese në të cilën njësia për herë të parë zbaton interpretiminose
- ii. Fillimi i një periudhe raportuese paraprake paraqitur si informacion krahasues në pasqyrat financiare të periudhës raportuese në të cilën njësia ekonomike e zbaton interpretimin e parë.

Ky interpretim nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- **Transferimet e Aktiveve afatgjata materiale të investuara - Ndryshimet në SNK 40**

Ndryshimet sqarojnë kur një njësi ekonomike duhet të transferojë aktivet afatgjata materiale, duke përfshirë ato në ndërtim në Aktive afatgjata materiale të investuara, ose e kundërta. Ndryshimet theksojnë se një ndryshim në përdorim ndodh kur prona përmbush, ose pushon së përmbushuri, përkufizimin e aktivitetit afatgjatë material të investuar dhe ka prova të këtij ndryshimi në përdorim. Në veçanti, një ndryshim në qëllimet e drejtimit për përdorimin e një prone nuk përbën provë të një ndryshimi në përdorim. Subjektet duhet të zbatojnë ndryshimet në mënyrë prospektive për ndryshimet në përdorim që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësia ekonomike i zbaton ndryshimet e standardit për herë të parë. Një njësi ekonomike duhet të rivlerësojë klasifikimin e pasurive të mbajtura në atë datë dhe, nëse është e aplikueshme të bëjë riklasifikimin e pronës për të pasqyruar kushtet që ekzistojnë në atë datë. Zbatimi retrospektiv lejohet vetëm nëse është në përputhje me SNK 8. Aplikimi i këtij standardi nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.



**- SNRF 2 - Klasifikimi dhe matja e Transaksioneve të "Pagesave të bazuara në aksione" – Ndryshime në SNRF 2**

BSNK publikoi ndryshime në SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione që adreson këto tre fusha: efektet e "konditave të kushtëzimit" mbi matjen e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të shlyera me mjete monetare; klasifikimin e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione me kushte për shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim; dhe kontabilizimin kur një modifikim i kushteve dhe termave të pagesave bazuar në aksione ndryshon klasifikimin nga të pagueshme me mjete monetare në të pagueshme me kapital. Njësitë kërkohet të aplikojnë ndryshimet pa riparaqitur periudhat e mëparshme, por aplikimi retrospektiv është i lejuar nese behet për të tre ndryshimet dhe nese plotësohen edhe kriteret e tjera. Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2018, me aplikim të më hershëm të lejuar.

Aplikimi i këtij standardi nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

**- Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet financiare me SNRF 4 Kontratat e sigurimit - Ndryshimet në SNRF 4**  
Ndryshimet adresojnë shqetësimet që dalin nga zbatimi i standardit të ri të instrumenteve financiare, SNRF 9, përpara zbatimit të SNRF 17 Kontratat e sigurimit, i cili zëvendëson SNRF 4. Ndryshimet prezantojnë dy opsione për subjektet që lëshojnë kontrata sigurimi: një përjashtim i përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 dhe një metodë mbivendosjeje. Përjashtimi i përkohshëm aplikohet për herë të parë për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018. Një njësi ekonomike mund të zgjedhë metodën e mbivendosjes kur ajo së pari zbaton SNRF 9 dhe e zbaton këtë qasje në mënyrë retrospektive ndaj aktiveve financiare të përcaktuara në tranzicion në SNRF 9. Njësia ekonomike rishikon informacionin krahasues që pasqyron qasjen mbivendosëse nëse dhe vetëm nëse njësia ekonomike rishikon informacionin krahasues gjatë zbatimit të SNRF 9. Këto ndryshime nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë.

**- SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta - Sqarim se matja e e te investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje specifike për cdo investim.**

Ndryshimet sqarojnë se:

- Një njësi ekonomike që është një organizatë sipërmarrjeje kapitalesh, ose një njësi tjetër që kualifikohet, mund të zgjedhë që në njohjen fillestare për secilin investim të saj vec e vec, të masë investimet e saj në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- Nëse një njësi ekonomike, që nuk është në vetvete një njësi ekonomike investuese, ka një interes në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që është një njësi ekonomike investuese, njësia ekonomike, në zbatimin e metodës së kapitalit neto, mund të zgjedhë të mbajë të njëjtën vlerë të drejtë të zbatuar nga njësia ekonomike investuese në interesat e saj në filiale. Këto zgjedhje bëhen veçmas për secilën njësi ekonomike investuese pjesëmarrje ose sipërmarrjeje e përbashkët, në datën më të vonshme në të cilën: (a) njësia ekonomike investuese ose ndërmarrja e përbashkët njihet fillimisht; (b) shoqëria ose ndërmarrja e përbashkët bëhet një njësi ekonomike investuese; apo (c) shoqëria e investimit ose pjesëmarrja e përbashkët bëhet Shoqëri me membra për here te pare.

Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë

**- SNRF 1 - Adoptimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar për herë të parë - heqja e përjashtimeve afatshkurtra për adoptuesit e parë**

Përjashtimet afatshkurtra në paragrafët E3-E7 të SNRF 1 u fshinë sepse qellimi i tyre është realizuar.

Ky ndryshim nuk është i zbatueshëm për Shoqërinë.

Aplikimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Kompanisë.

**Standarte të emetuara por që ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe nuk janë adoptuar**

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të Kompanisë janë dhënë më poshtë. Kompania synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato hyjnë në fuqi.



- **SNRF 16 - Qiratë**

BSNK publikoi standardin e ri për kontabilizimin e qirave - SNRF 16 Qiratë në Janar 2016. Standardi i ri nuk ndryshon shumë kontabilizimin e qirave nga qiradhënesit. Megjithatë, kërkon që qiramarrësit të njohin në bilancin e tyre kontabël të gjitha qiratë si detyrime si dhe aktivet koresponduese. Qiramarrësit duhet të përdorin një model të vetëm për njohjen e të gjitha qirave, por do të kenë opsionin të mos njohin qiratë afatshkurtra ose qiratë për aktive me vlera të vogla. Në përgjithësi, modeli i njohjes do jetë i ngjashëm me atë që përdoret aktualisht për kontabilizimin e qirave financiare, me interesin dhe shpenzimin e amortizimit të njohur në zëra të vecantë në pasqyrën së fitimit ose humbjes. SNRF 16 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2019. Aplikimi më herët është i lejuar nëse standardi i ri i të ardhurave, SNRF 15 aplikohet në të njëjtën datë. Qiramarrësit duhet të adoptojnë SNRF 16 duke përdorur ose metodën e plotë retrospektive ose metodën e modifikuar retrospektive. Shoqëria nuk synon të aplikojë këtë standart .

- **SNRF 17 Kontratat e sigurimit**

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (SNRF17), një standard i ri kontabël gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve që mbulon njohjen dhe matjen, prezantimin dhe shënimet shpjeguese. Pasi të bëhet efektiv, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) që është nxjerrë në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth., jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi), pavarësisht nga lloji i subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionare. Do të ketë disa përzjastime nga objektivi.

**3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)**

**Standarte të emetuara por që ende nuk kanë hyre në fuqi dhe nuk janë adoptuar (vazhdim)**

Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model kontabiliteti për kontratat e sigurimit që të jetë më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguruesit. Në kontrast me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. SNRF 17 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2021 dhe zbatimi i tij kërkon paraqitjen e vlerave krahasuese të periudhave të mëparshme. Aplikimi i mëparshëm është i lejuar me kusht që Shoqëria të aplikojë SNRF 9 dhe SNRF 15 më ose përpara datës së aplikimit të SNRF 17.

Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë

- **KIRFN 23 Interpretimi - Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit Mbi të Ardhurat**

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasiguri që ndikojnë në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesa lidhur me interesat dhe penaltitete që lidhen me trajtimin e pasigurt tatimor.

Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një njësi ekonomike i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç.
- Supozimet që një njësi ekonomike bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore.
- Si një njësi ekonomike përcakton fitimin e tatuueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore

Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore. Qasja që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë duhet të ndiqet. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, por janë të disponueshme disa lehtësime të tranzicionit.

Kompania nuk parashikon adoptimin e hershëm të interpretimit dhe aktualisht vlerëson ndikimin e saj.

- **Ndryshimet në SNRF 9: Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ**

Sipas SNRF 9, një instrument borxhi mund të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që flukset monetare kontraktuale të jenë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të mbetur (kriteri i SPPI) është mbajtur në



Amendamentet sqarojnë se kur një njësi ekonomike merr kontrollin e një biznesi që është një operacion i përbashkët, ajo zbaton kërkesat për një kombinim biznesi të arritur në fazë, duke përfshirë rivlerësimin e interesave të mbajtura më parë në aktivet dhe pasivet e operacionit të përbashkët me vlerë të drejtë. Duke vëpruar kështu, blerësi e rimballon të gjithë interesin e mbajtur më parë në operacionin e përbashkët. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kombinimet e biznesit për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019, me lejen e aplikimit të hershëm. Këto ndryshime do të zbatohen për kombinimet e ardhshme të biznesit të Kompanisë.

#### - SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta

Një palë që merr pjesë, por nuk ka kontroll të përbashkët, një operacion i përbashkët mund të marrë kontroll të përbashkët të veprimtarisë së përbashkët në të cilën veprimtaria e operacionit të përbashkët përbën një biznes siç përcaktohet në SNRF 3. Amendamentet sqarojnë se interesat e mbajtura më parë në atë operacion të përbashkët nuk janë rimarrë. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në transaksionet në të cilat ai fiton kontroll të përbashkët në ose pas fillimit të periudha e parë e raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019, me lejetimin e aplikimit të hershëm. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Kompaninë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

#### - SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat

Amendamentet sqarojnë se pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve lidhen më drejtpërdrejt me transaksionet e mëparshme ose ngjarjet që gjenerojnë fitime të shpërndara sesa shpërndarjet tek pronarët. Prandaj, njësi ekonomike njeh pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në fitim ose humbje, të ardhura të tjera përmbledhëse ose kapital sipas vendit ku njësi ekonomike fillimisht ka njohur ato transaksione ose ngjarje të mëparshme.

Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, me lejen e aplikimit të hershëm. Kur një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime, ai i zbaton ato në pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve të njohura në ose pas fillimit të periudhës së hershme krahasuese.

Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Kompaninë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

#### - SNK 23 Kostot e Huamarrjes

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike trajton si pjesë e huamarrjes së përgjithshme çdo huamarrje të bërë fillimisht për të zhvilluar një aktiv të kualifikuar kur në tërësi të gjitha aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e atij aktivi për përdorimin ose shitjen e synuar janë të plota. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kostot e huamarrjes të bëra në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, me lejen e aplikimit të hershëm.

Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Kompaninë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

#### - Ligji i ri kontabël në Shqipëri

Pas përpjekjeve të qeverisë shqiptare në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Kuvendi i Shqipërisë miratoi më 10 maj 2018 ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i ri mbi Kontabilitetin ose Ligji i Ri), i cili zëvendëson ligjin e mëparshëm nr. Ligji i ri mbi Kontabilitetin është përafëruar pjesërisht me Direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian me qëllim të harmonizimit të plotë në vitin 2028. Ligji i ri hyri në fuqi nga 1 janari 2019.

Zbatimi i ligjit të ri kontabël nuk ka efekt mbi pozicionin financiar dhe performancën e Kompanisë.

Kompania ka zgjedhur të mos i miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave të tyre efektive. Kompania parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike në periudhën e aplikimit fillestar



#### 4. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Disa politika kontabël dhe shënime shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet si financiare ashtu edhe jo-financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar për qëllime matje dhe/apo shpjeguese bazuar në metodat e mëposhtme. Aty ku është e aplikueshme, informacion i mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet përkatëse të atij aktivi apo detyrimi.

##### *Aktivitetet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar*

Vlera e drejtë për llogaritë e arkëtueshme është vlerësuar me vlerën aktuale të flukseve të ardhshme monetare, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit. Drejtimi ka njohur si vlerë të drejtë koston historike për mungesë të tregut të vlerësimeve. Kjo vlerë e drejtë është përcaktuar për qëllime shënimi shpjegues.

##### *Detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar*

Vlera e drejtë, e cila është përcaktuar për qëllime shënimi shpjegues, është llogaritur bazuar në vlerën aktuale të flukseve të ardhshme të principalit dhe interesit, skontuar me normën e tregut të interesit në datën e raportimit.

Vlera e drejtë për mjetet monetare dhe ekuivalente me to, llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme është afërsisht e barabartë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të maturitetit të tyre afatshkurtër.

#### 5. Administrimi i riskut financiar

Shoqëria ekspozohet ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumentave financiarë:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozimet e Shoqërisë ndaj secilit nga risqet e sipërpërmendur, objektivat, politikat dhe proceset që ajo përdor për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut. Shënime të tjera sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare. Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve.

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve e procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, huamarrje dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

##### *Rreziku kreditor*

Ekziston një rrezik kredie në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre lidhur me pagesat e llogarive të arkëtueshme.

Maksimumi i rrezikut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Rreziku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve. Shoqëria e vlerëson cilësinë e llogarive të arkëtueshme që nuk janë me vonesë dhe as të zhvlerësuara si të kënaqshme.

#### 5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

##### **Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor**



(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

Vlera e mbartur e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë. Ekspozimin maksimal ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	Shenimi	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme	8	0	0
Të drejta ndaj palëve të lidhura	9	23.173.453	23.894.009
Llogari të arkëtueshme	10	4.509.192	786.792
Paraja dhe ekuivalentet e saj	11	237.439.017	220.662.092
		<b>265.215.212</b>	<b>245.436.443</b>

Nuk ka një përqendrim të rëndësishëm të rrezikut të kredisë.

**(i) Risku i likuiditetit**

Shoqëria duhet të përmbushë nevojat për mjete monetare, kryesisht për kostot e shfrytëzimit që rrjedhin nga aktiviteti i saj. Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme. Shoqëria monitoron likuiditetin e saj periodikisht në mënyrë që të administrojë detyrimet e saj kur nevojitet. Shoqëria administron rrezikun kryesisht përmes mbështetjes së financimit afatshkurtër dhe afatgjatë prej bankave dhe palëve të lidhura.

**Ekspozimi ndaj riskut të likuiditetit**

Më poshtë janë paraqitur maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare në 31 dhjetor 2019 dhe 2020:

	31 dhjetor 2020				Totali
	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-
Të drejta ndaj palëve të lidhura	-	-	-	23.173.453	23.173.453
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	4.509.192	4.509.192
Paraja dhe ekuivalentet e saj	237.439.017	-	-	-	237.439.017
	<b>237.439.017</b>	-	-	<b>27.682.645</b>	<b>265.215.212</b>
Huamarrje	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	-	-	-	-23.173.453	-23.173.453
Llogari të pagueshme	-3.558.660	-	-	-	-3.558.660
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-
	<b>-3.558.660</b>	-	-	<b>-23.173.453</b>	<b>-26.732.113</b>
<b>Ekspozimi neto</b>	<b>233.880.357</b>	-	-	-	<b>233.185.364</b>
<b>Kumulative</b>	<b>233.880.357</b>	-	-	<b>4.509.192</b>	<b>233.185.364</b>

**5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)****(ii) Risku i tregut****Risku i normës së interesit**

Shoqëria përballlet me ndikimin e flukseve të parasë nga norma e interesit lidhur me huatë që ka marrë dhe detyrimet e qerasë financiare dhe detyrimi ndaj Ford Werke GmbH. Manaxhimi i Shoqërisë nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje për instrumenta derivativë me qëllim mbrojtjen nga ky risk.

**Ekspozimi ndaj riskut të normës interesit**

Nuk ka ekspozim ndaj riskut të kredisë.

**Risku i kurseve të këmbimit**

Shoqëria kryen transaksione kryesisht në Lekë, Euro dhe USD.



Risku i monedhës kryesisht manaxhohet duke përdorur parimet e përputhjes së të drejtave dhe detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontrata të ardhshme shkëmbimi më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

## 5. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

### (iii) Risku i tregut (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit (vazhdim)

Kursi i këmbimit të Lek-ut në përfundim të periudhës raportuese ishte si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
1 USD	100.84	108.64
1 EUR	123.70	121.77

### (iv) Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente rregullatore.

## 6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivt afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Ndërtesa dhe instalime	Pajisje	Automjete	Mobilje dhe pajisje zyre	Totali
<b>Kosto</b>					
Në 1 janar 2020	15.875.000	18.747.715	-	-	34.622.715
Shtesa	-	1.181.655	-	-	595.600
Pakësime	-	-	-	-	-
Në 31 dhjetor 2020	15.875.000	19.929.370	-	-	35.804.370
<b>Amortizimi i akumuluar</b>					
Në 1 janar 2020	-1265.039	-15.501.782	-	-	-16.766.821
Amortizimi i vitit	-730.498	-785.185	-	-	-1.515.603
Pakësime	-	-	-	-	-
Në 31 dhjetor 2020	-1.995.537	-16.286.967	-	-	-18.282.424
<b>Vlera kontabël</b>					
Në 31 dhjetor 2019	15.378.906	3.598.277	-	-	18.977.183
Në 31 dhjetor 2020	14.609.961	3.245.933	-	-	17.521.946

35.804.370



**6. Inventarë**

Inventarët në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Materiale	93.550	93.550
<b>Totali</b>	<b>93.550</b>	<b>93.550</b>

Nuk ka Rënie në vlerë e inventarit.

**7. Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogari të arkëtueshme	23.173.453	23.894.009
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**8. Të drejta ndaj palëve të lidhura**

Të drejta ndaj palëve të lidhura në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Ortakët (kredi e marre për përdorim personal)	23.173.453	23.894.009
<b>Totali</b>	<b>23.173.453</b>	<b>23.894.009</b>

**9. Mjete monetare dhe ekuivalente me to**

Mjete monetare dhe ekuivalente me tonë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Vlera në arkë	32.557.697	95.614.948
Vlera në banka	204.881.320	125.047.144
<b>Totali</b>	<b>237.439.017</b>	<b>220.662.092</b>

**10. Kapitali aksioner**

Më 31 Dhjetor 2019 vlera e kapitalit aksionar të autorizuar, rregjistruar dhe paguar të Shoqërisë 185.000.000 (2018: Lek 185.000.000), me vlere prej Lek 61.666.666 për kuote. Më poshtë jepet përmbledhja e kuotave të kapitalit në fund të çdo viti:

	31 December 2019			31 December 2018		
	Number of quotas	Ownership %	Lek	Number of quotas	Ownership %	Lek
Edmond Ymeri	1	33.33	61.666.667	1	33.33	61.666.667
Ilir Janku	1	33.33	61.666.667	1	33.33	61.666.667
Ali Topalli	1	33.33	61.666.667	1	33.33	61.666.667
	<b>3</b>	<b>100</b>	<b>185.000,000</b>	<b>3</b>	<b>100</b>	<b>185.000,000</b>



**11. Huamarrje AFAT SHKURTERA DHE AFAT GJATA**

Huamarrje afatshkurtra në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	-	-
<b>Totali</b>	-	-

Huamarrje afatgjata në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
HUA BANKARE-personale e ortakeve	23.173.453	23.894.009
<b>Totali</b>	<b>23.173.453</b>	<b>23.894.009</b>

**12. Detyrime ndaj palëve të lidhura**

Detyrime ndaj palëve të lidhura në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	-	-
<b>Total</b>	-	-

**13. Llogari të pagueshme**

Llogarite e pagueshme në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të pagueshme	-	-
<b>Total</b>	-	-

**14. Detyrime të tjera**

Detyrimet e tjera në 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të pagueshme ndaj punonjësve		
Tëthëra tëpagueshme		
Parapagime te marra		
Tatim Fitimi i pagueshem	2.670.091	940.913
TVSH e pagueshme		
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme	687.196	428.927
Tatim në burim	171.810	110.070
<b>Totali</b>	<b>3.529.097</b>	<b>1.563.083</b>

**15. Të ardhura nga aktiviteti kryesor kembimi**

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga KEMBIMI VALUTOR	118.570.994	89.299.405
<b>Total</b>	<b>118.570.994</b>	<b>89.299.405</b>

**16. Kosto e shitjeve**

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019
Kosto të tjera llog 605-608	(-3.168.380)	(-4.074.108)



<b>Totali</b>	<b>(-3.168.380)</b>	<b>(-4.074.108)</b>
---------------	---------------------	---------------------

**17. Shpenzime personeli**

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019
Paga dhe bonuse	-24.518.698	-20.531.233
Sigurime shoqërore	-3.631.933	-2.968.018
<b>Totali</b>	<b>-28.150.631</b>	<b>-23.499.251</b>

**18. Shpenzime të tjera operative**

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020
Qera	15.432.452
Mirembajtje dhe riparime	5.000
Sigurime	19.162
Personeli jashte njesise	236.000
Reklame ,publicitet	
Shpenzime postare e telekom	3.004.516
Sherbime bankare	6.960.460
Taksa dhe tarifa vendore	2.119.161
Tatime te tjera	727.570
Shpenzime te tjera	10.000
Gjoha	6.110
<b>Totali</b>	<b>28.520.431</b>

**19. Shpenzime financiare neto**

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019
Te ardhura nga intersat neto	1.960	15.935-
Të ardhra nga ndryshimi i kursit të këmbimit neto	1.507.499	183.296-
<b>Shpenzime financiare neto</b>	<b>1.509.459</b>	<b>199.231-</b>

**20. Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën 15% të fitimit të tatueshëm (2017: 15%). Më poshtë paraqitet një rakordim i tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e taksës së aplikueshme me shpenzimin e tatimit mbi fitimin:

	Norma efektive e tatimit	Viti i mbyllur 31 dhjetor	
		2019	Norma efektive e tatimit 2018
Fitimi para tatimit		58.725.408	40.434.050
Tatimi fillestar	15%	6.246.668	15% 6.065.108
Shpenzime pa njohura		743.680	224.662-
<b>Shpenzimi i tatim fitimit</b>	<b>15.08%</b>	<b>-8.920.363</b>	<b>15% 6.098.807</b>



**ILIRIA 98 Sh.p.k**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

*(Të gjitha shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)*

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 nuk ka patur diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të raportuara për qëllime tatimore. Rrjedhimisht, nuk është njohur aktiv ose detyrim tatimor i shtyrë në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

**21. Detyrime të kushtëzuara dhe angazhime**

Nuk ka detyrime dhe angazhime të tjera në mbyllje të vitit 31 dhjetor 2019.

**22. Transaksione me palët e lidhura**

Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura paraqitet më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019
Aktiv/(Detyrim)	23.173.453	23.894.009
Të drejta ndaj palëve të lidhura (shënimi 14)	23.173.453	23.894.009
Të ardhura/(Shpenzime)	-	-

**23. Ngjarje pas datës së raportimit**

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër të ndodhur pas datës së raportimit, e cila mund të kërkonte rregullime apo shënime shtesë në pasqyrat financiare.



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.